

BIBLIOTEKA  
SHTEJIT

SH-1  
240



**KËNGA  
E AGIMEVE  
MALORE**

**PREND  
UKAJ**

---

**POEZI**

854-1  
          
240

PREND UKAJ

# KËNGA E AGIMEVE MALORE

*poezi*



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

LIBRI D'ARTI

LIBRI D'ARTI  
MILANO

1976

Tirazhi 1500 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

---

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1976

## MERRINI KËTO VARGJE

Më këmbë kryqetërthor u rashë viseve të mia  
nga luginat bri lumenjve e deri te rrëzat e bjeshkëve  
dhe më lindën këto vargje, ngrohur nga dashuria  
e malësorëve të mirë: të rinjve e pleqve.

Merrini këto vargje të thjeshta, i sjell për ju  
me drojtjen e udhëtarit që nis rrugë të pashkelur;  
do gjeni në to pasqyruar copëza qielli blu,  
rapsodi gurrash e aromë lulësh derdhur;

një kantier të ri që diku hedh shtat,  
ngritur nga duar e zemra punëtorësh;  
në sfond malesh profilin e një pushke të gjatë  
atavizma jonë në shtegtim pafund shekujsh.

Më këmbë kryqetërthor u rashë viseve të mia  
e vargjet m'u njomën me baltën e ugarit.  
Merrini, dhuratë jua sjell, o njerëz të mirë,  
zemrën kam mbjellur në hullitë e vargut...



## BIRI I RAPSODIT

Dy tela të gjatë çiftelie pat tendosur babai  
nën qiellin e ftohtë të kasolles së tij;  
e ia pat thënë një kënge plot dhembje,  
një rapsodie të gjatë nën qiellin e kasolles së tij...

Tregonte kënga për një rrah, për një brinjë,  
tregonte kënga për një vatër, për një trim;  
«Randë po vijnë, nanë, lotët e tue,  
bash si gurë e dhe mbi muc...»

Dy tela të gjatë çiftelie tendosi i biri;  
nga vibracionet e saj mbinë këngë të reja  
për grunjat që harlisen ndër tarraca,  
për dritat që ia behën ndër kulla, për dasmat...

Mbi çifteli, si mbi një hon të thellë, u përkul biri i rapsodit  
dhe u mbushën bjeshkët me melodi të reja rapsodish...

## NË SHTËPINË MUZE TË POETIT

Kam ardhur në shtëpinë tënde, Migjen,  
si mysafir i vonuar  
që mes dyerve të tjera kërkon derën e mikut.

Kam ardhur të pushoj në konakun tënd!  
Ti më uron me fjalë mirëseardhjen  
dhe pranë vetes më bën vend  
si një miku të vjetër, të largët,  
që dikur i ke njohur babanë...

Babanë tim ti e ke futur në legjendë,  
Migjen!

## NË KULLËN TIME TË LASHTË, TË VJETËR

Në kullën time të lashtë, të vjetër  
zot këtu qemë vetë ndër shekuj.

As gjyshi, as stërgjyshi, as baba, djalë mbas djalit,  
për mëshirë s'ia shtrinë dorën as mbretit, as krajlit.

Në kullën time të fortë prej guri  
çdo gur i murosur është një zemër burri.

Në ballin e saj, tashmë shndërruar në legjendë,  
epokat emrat e tyre i kanë gdhendë...

Kulla ime e lashtë, me kulm pak të harkuar,  
përherë një vesh e një sy e mban zgjuar...



## HAPSANI

*Në një kodër të fshatit tim turqit ngritën bur-  
gun e tyre. Kodra mban emrin Hapsan.*

Një kodër e zhveshur ndanë fshatit tim,  
ku rrahin erërat e rrahin stuhitë.  
Nga e more këtë emër, ç'fat jetim  
të pllakosi ty e treti dashurinë?...

Nga e more këtë emër, cili turk ta dha, —  
mallkuar i qoftë emri, mallkuar edhe varri!  
Stërgjyshit trim për një pikë ujë buza iu tha  
në qelinë e errët, po s'jepej shqiptari.

E shtrenjtë është toka, e shtrenjtë liria;  
kur ta rrëmben i huaji — të jetosh nuk bën!  
S'e zinte malësinin përbrenda shtëpia,  
mbi karakoll nxinte flamuri gjysmëhënë...

Një moti u trandën malet shekullorë  
nga piskamat dhe krismat e hutave,



dheu filloi të hapte varre për zabitët  
që më s'u besonin lutjeve e skutave. . .

Skutë asgjëkundi nuk u dha armiqve toka ime,  
asgjëkundi s'u la emër as farë!

Veç mbetën si kujtime të hidhura për brezat  
emra të tillë vendesh si emri turk Hapsan.

# RAPSODI

## 1.

Ti bëre këngë e këngët e tua  
i këndonim në dasma, i këndonim në luftë.  
Ishin kohë të vështira atëherë,  
na duheshin këngë, këngë shumë.

Na duheshin për të pajtuar nënën,  
na duheshin për të burrrëruar djalin  
që armiku të thyente dhëmbët,  
që trimat të mësynin malin...

## 2.

..Burri nuk dorëzohej gjallë  
nga gjithë anët i rrethuar;  
kullë e moçme merrte flakë,  
trimi digjej përvëlur...

Kënga ngrihej që nga hiri  
e buçiste mal më mal  
si bori e gjallë kushtrimi,  
këngë prush e këngë zjarr...

3.

Ti bëre këngë e këngët e tua  
i këndojmë në dasma, i këndojmë në festë.  
Kënga rrjedh e qetë, si krua,  
kënga rrjedh e shtë...

## MOTIVET E MIA

Motivet e mia, mbirë mes pishave të blerta,  
derdhen si ujvara bjeshkësh  
sa herë në kopshte vjen pranvera  
e lule çelin kumbullat, pjeshkët...

Motivet e mia, mbirë mes misrit e grurit,  
ngrohur nën diellin e ëmbël të veriut  
i mbledh aty-këtu këtyre viseve të gurit,  
që himnin më të bukur t'i thurin tokës dhe njeriut.

Motivet e mia! Ngaherë pas jush kështu do rend:  
me mendimin në kokë të qartë, të vetëdijsëm  
që vargu të rrjedhë i pastër argjend,  
që vargu të rrjedhë gjithmonë i partishëm.



## MBRËMJE BJESHKËTARE

Mbrëmja mbi bjeshkë është bërë gati të bjerë,  
hëna pas Sukës po nxjerr vetullën e djegur;  
nga ashtë e dendur vjen e lehta erë  
aromën e rudinave mbi kreshta duke sjellur.

Këmborë e zëra lugjeve jehojnë...  
tufat e bashkuara nisen për në stan;  
bareshat para u prijnë, në torishta\* i rehatojnë,  
një tranzistor melodi përhap mbi rrah...

O mbrëmje hareplotë, mbrëmje bjeshkëtare,  
ç'kujtime bonjake më zgjuat sonte ju —  
një blegërimë e humbur më bëzan nga livadhet,  
ku vrapon fëmijnia ime, mbetur mrizeve diku...

---

\* vathë.

## ÇAST MBRËMJEJE

Mbrëmja e vonuar në fushë më zuri  
tek kthehesha nga puna me fshatarët.  
Ndrin hëna në qiell me fytyrën si nuri  
mbi duajt e korrur, mbi mullarët...

Qeshnin djemtë çapkënë dhe bënin shakara,  
me vajzat bukuroshe ndërronin vështrime.  
Filladi krahëlehtë që frynte nga mali  
në fshatin mbi kodër zërat i shpinte.

Mua një varg më mundonte këto çaste  
për vjeshtën e artë, për mbjelljet dhe dasmat.

## KOOPERATIVISTET E FSHATIT TIM

Kooperativistet e fshatit tim,  
vajza e gra bujkeshë të mira,  
të parat diellin përshëndesin në agim,  
në sytë e qeshur u shndrit lumturia.

Të tyret janë grunjat që fërfërijnë në tarraca  
dhe misrat flokëgjelbër harlisur në arë.  
Dashurinë rrisin vajzat, si bimën në brazda,  
për djemtë e bukur, për djemtë fshatarë...

Muzgjeve të vona, kur kthehen prej punës,  
me tufa kallëzash mbetur në flokë,  
nënat qumështin e gjirit ua mëkojnë fëmijëve  
dhe urojnë të bëhen bujqër të zotë.



## MES GRUNJAVE TË REJA

Duke u gjendur mes fushave në vjeshtë  
në kokë më lindin plot mendime  
dhe them se s'mund të jesh kurrë poet,  
pranë tokës po s'u gjende.

...Kallinjtë e hollë, ja, kryet përkulin  
dhe grunjat luhaten nën flladin fërfëritës;  
unë ndiej, tek ngrihet, erën e brumit  
nga furra e re e kooperativës...

Ndiej shqetësimin e bujkut në arë  
për farën ndër brazda mbirë;  
kur bukën e grurit në darkë e ha  
haram e kam po s'pata dërsirë.

Ndaj kur mbillet gruri në vjeshtë  
me fshatarët mes fushës unë gjendem,  
deri në bërryla mëngët i përvesh  
dhe me shat shkërmoq plisat e rëndë...



Në kopshtet me mollë ka ardhur vjeshta,  
degët e mollëve kërrusur përmbi tokë.

Vijnë t'i mbledhin mollët vjelëset,  
me shamitë e bardha në kokë.

Mes gjetheve kryet zgjasin frutat e pjekur,  
sikur duan në ndarje të përshëndeten me vjeshtën...

Mes gjetheve, si lara bore, shamitë e bardha, —  
shpirtin ç'ma pushtoi e frymëzimit dallga!

## KUJTIMI I NËNËS

Kujtimi i nënës  
me duart e djegura në çerrep.

Kujtimi i nënës  
me ninullën e motrës motake  
në djep.

Kujtimi i nënës  
në zemrën time —  
flakë malli...

Kujtimi i nënës  
te bija ime përtrirë  
në belbëzimin e ëmbël:  
«O nënë, nëna ime e mirë!»



14318

## PO TA SHOH BALLIN

*Pashka Prelës, që ra në përleshje me  
diversantët.*

Po ta shoh sot ballin tënd të përgjakur  
në atë ditë vjeshte.

O, çka të them për atë ballë, për ata sy të përflakur  
që mbetën përherë çelur mbi kreshtë.

Kanë kaluar 21 përvjetorë që prej vrasjes sate, Pashka,  
dhe gjethet e mollës 21 herë në oborr të kullës kanë rënë,  
dhe akoma pragu i derës t'i ruan gjurmët e gjakut,  
dhe akoma lugina ta ruan jehonën e zërit:

«Kapini vrasësit!»

Atij muzgu ujvarat dhe erërat e morën emrin tënd  
t'ua përcjellin viteve e brezave  
dhe gërmat t'i kanë latuar mbi një gur të bardhë,  
ku vogëlushët lule lënë pranverave.

Po ta shoh sot ballin tënd shpat bjeshke,  
po t'i shoh sot sytë e tu gurra rudine;  
këtu vitet prorë kanë për të sfiduar vdekjen,  
këtu brezat prorë musht lirie kanë për të pirë...



## UNË DHE SHARRËXHINJTË

Unë jam bir i sharrëxhinjve...  
Kam lindur nën pishat mes pyjeve,  
dhe prindët e mi kanë lindur mes pyjeve:  
unë — vazhdimësia e tyre.

Për çdo mbrëmje dhe për çdo mëngjes  
hyj në baraka dhe dal nga barakat  
me gazin e sharrëxhiut që nuk sos përjetë;  
me kujdesin e rojtarit për lastarët.

Ndaj jo rastësisht ata më vijnë në këngë  
nga shpatet me capinat e sharrat në krah;  
me bujarinë e malësorit më thërresin pranë  
kur hanë drekën — të ha me ta...

Më thërresin t'u shkoj pas ndër prozimet e shpeshtë;  
me ta trupat t'i lëshoj në koritë,  
për ta të shkruaj ndonjë reportazh e vjershë,  
që mbas punës ta lexojnë ndonjë ditë.

Prej vitesh këtu jam me këta njerëz  
në barakat e thjeshta, në barakat e pyjeve.  
Dhe para vizitorëve prezantohem thjeshtë;  
unë jam biri i sharrëxhinjve...



## NË MUZGUN E QYTETIT VERIOR

Në muzgun e qytetit verior të sharrëxhinjëve,  
takova një shokun tim druvar.  
Kish në sy gjelbërimin e pishave,  
si pishë e lartë shtati i tij përngjan.

Mbante në sup një motosharrë.  
(Prej Lakut të Hithit sa kishte zbritur.)  
Do ta çoj në ofiçinë, —tha  
dhe sytë i hodhi tej pyjeve me pisha...

Kuptova. Ajo s'ish thjeshtë një frazë,  
s'ish vetëm një ndjenjë, një mendim.  
Unë duhet të shkruaja një vjershë të gjatë, të gjatë  
për duart e regjura të shokut tim.

## RA SHARRËXHIU

Ra sharrëxhiu... .

Të them pishat shtrinë degët si krahë ta mbanin,  
të them burimet rendën t'i njomnin buzët e rreshkura,  
të them bari e lulet u thanë ndër livadhe —  
ç'do të them pastaj për sharrëxhinjtë,  
për shokët e tij të jetës?!...

Sa qe gjallë ata i ndenjën aq pranë  
në rrugë, në mensë, në barakat e pyllit;  
bashkë sharruan drurë në pishnajë,  
bashkë kënduan, kërcyen e i ranë fyellit.  
Atë ditë ata i pikëlloi shumë vdekja e shokut,  
nuk qeshën, as nuk bënë shaka fare...  
Për të të gjithë e tejkaluan normën  
dhe njëri, kur ktheheshin, ngriti këngë

për birin e malit...

## BALADA E GJYSHIT DRUVAR

Thonë e ka pasur shtatin të lartë sa të një ahu,  
thonë e ka pasur fytyrën sa të një shpati bjeshke,  
thonë e ka pasur pendën e mustakut sa krahu,  
thonë shumë gjëra për gjyshin tim kreshnik, të vdekur.

Thonë me zërin e tij të trashë, që malet i tundte,  
zotërinjtë zgjonte në pallatet e kristalta,  
thonë kur kalonte ai bri avllive të larta në rrugë  
zonjat e dhjamura, pas grilave, i zinte data...

Thonë gjyshi im në sup mbante një sëpatë e një sharrë  
e kryqetërthor rrugëve u binte pa pre...  
Sokakut, muzgjeve dhe agimeve, klithte piskamë:  
«Dru me pre! Dru me pre!»...

Thonë, një ditë u shtri, më për të mos u ngritur  
me sëpatën e sharrën pranë;  
përreth mblodhi mbesa e nipër  
e u tha: «Bij, luftoni! Grami duhet shkukur me rrënjë!»



## JAM I EMOCIONUAR

Unë jam i emocionuar  
kur kaloj mes punëtorëve,  
mes gërshetimeve të rrugëve  
që mbijnë si deje buzë Drinit.

Unë jam i emocionuar...  
Dikur këtu lozja me shokët  
zhytesha ndër valë e shtrihesha në rërë, kullotja grigjët.  
Tani ekskavatorët zhvendosin peisazhet rrotull,  
ndryshojnë arkitekturën e lashtë të brigjeve.

Unë jam i emocionuar  
dhe kur më godet në brinjë frymëzimi  
dhe kur Marashi, nxënësi im, më jep për të lexuar  
vjershat e tij të para për Fierzën e dritës...



## ATY KU LINDI KANTIERI I RI

Ndër livadhe lule mblidhja dhe i bëja kurorë  
për të hijeshuar qafën e qingjave;  
me moshatarët loznim e kërcenim dorë për dorë  
e zhyteshim në Drin mes ujërave...

Këto mbaj mend nga fëmijnia e hershme —  
tani ato gjurmë të dashura kudo janë shuar...  
Këtu një ditë hodhi shtat kantieri,  
baraka për punëtorët janë ndërtuar.

Veç lulet që çelin fshehur nën shelgjishte  
prapë i mbledh e ia dhuroj shoqes sime elektriciste...

## BUNARI I GRISHIT

Bunari i Grishit grishte çobanët  
me ujin e freskët, të akullt të bjeshkëve.

Bunari i Grishit grishte grigjët  
të hanin barin e vesuar dhe gjethet.

...Po një ditë i la grigjët e çobanët në mal  
dhe rendi poshtë në hidrocentral. . .

Banorët e kantierit tani, kur ujin pijnë,  
kujtojnë grigjët në kullotë, kujtojnë barinjtë. . .

## SALDATORJA RITA KA DY FËMIJË...

Saldatorja Rita ka dy fëmijë,  
dy kolopuçë si dy yje të bukur,  
që prorë shqetësohen për nënën  
kur netve të acarta ka turnin.

Dhe zgjohen prej gjumit ata shpeshherë:  
A do të vijë mami? — babin pyesin.  
Ai flokët me dashuri ua përkëdhel  
dhe në dy faqet i puth vogëlushët...

Saldatorja Rita ka dy fëmijë  
me emrat Drita dhe Dritan.  
Buzëqesh kantieri në bebëzat e tyre,  
kur nëna në prehër i mban...



## TËMIJËT E HIDROCENTRALIT

*Nxënërsve të mi të klasës së tetë*

Tëmijë,  
indur e rritur kantiereve,  
buzë lumenjve.

Zogj shtegtarë,  
që shkëlqimin e diellit në sy e fytyra e kanë.

Nga buza e tyre derdhet dallga e bardhë  
e Drinit

dhe kënga e turbinave.

Çdo mëngjes më sjellin në klasë  
zemrën punëtore të kantierit të madh.

## MOTIV NGA KURBNESHI

*F. Kaçorrit, minatorit hero.*

Heroizmi pëshpërit emrin dhe baladën e tij  
në këtë qytet  
dhe njerëzit në çdo 14 shtator e kujtojnë me iga  
një bujëte...

Secilit në këtë datë i rigon nga një kujtim,  
secilit në këtë datë i kallet nga një betim.

Minatorët, fëmijëve ua vënë emrin e tij  
dhe galeritë ia ruajnë baladën në gji.

## PËR GRIGJAT

Për grigjat shpesh mua malli më merr  
kur i shoh tek hanë barin në lëndina  
dhe në muzg te shtegu dal e i pres.  
kur zbresin tufa-tufa nga kodrina.

Më gufon në shpirt blegërima e tyre e bardhë,  
siç gufon qumështi curril në vedra;  
dua t'i tund gjithë këmborët e deshëve me radhë  
që ndër stane mban bjeshka...



## U FEJUA MOTRA...

Ka disa ditë që u fejua motra,  
ka disa ditë që motra duket e menduar...  
Në sytë e rimitë i pasqyrohet një tjetër shtëpi  
dhe një kopsht me qershi...

Ka disa ditë që u fejua motra,  
në fytyrë i bulëzon një shkëlqim i ri,  
mbesën përkëdhel dhe e puth me dashuri...

## KUR PIKOJNË STREHËT PRANVERAVE...

Kur pikojnë strehët pranverave  
lulet e bardha të mollës çelin në kopshtije,  
bari i njomë bleron livadheve  
e gjethet e reja buisin në pyje.

Kur pikojnë strehët pranverave  
avullojnë brazdat në tokën plot vlagë,  
rendin vajzat kooperativiste ugareve,  
u bëhen pulpët rozë me baltë...

Kur pikojnë strehët pranverave  
e shiu pikë-pikë bie mbi çati  
të rinjtë udhë u japin ëndrrave,  
sytë e menduar shprehin dashuri...

## GJYSHJA IME DHE KËNGËT

Gjyshja ime i donte shumë këngët,  
ishte këngëtare e zonja  
(shpesh e kisha dëgjuar tek këndonte fshehtas).  
Po gjyshja vdiq.  
Veç meje nuk ia dëgjoji njeri këngët...

Tani, kur vjen maji tufa bari mbijnë te bregorja  
e mbi varrin e gjyshes vërshëllejnë lehtë, si këngë,  
në krahët e zefirit...

M'u kujtua gjyshja sot e në kraharor zemra  
m'u drodh prej mallit  
tek këndonin e i binin çiftelisë vajzat e fshatit  
në skenën e festivalit...



## «TI JE PRAPË MES NESH, O TRIM I RI»

*Dëshmorit Frok Peraj, birit të fshatit  
tim që ra në luftë me kriminelët.*

Fshati ynë  
me strallin e shkëmbit  
i rriti shtatin birit të tij.  
Bjeshkët i patën dhuruar  
shikimin e skifterit në sy...

Shpinën kurrë s'ia pa armiku,  
as kur plumbin e namur i pati nisë.  
Jeta ime, tha, qoftë një gur i fortë  
në kështjellë të lirisë.

.....  
Në rritën\* e jetës,  
vajzat e vendlindjes  
ia thonë këngës me krenari:  
«Ti je prapë mes nesh, o trim i ri!»

---

\*) moshë e rinisë

## MARA, NXËNËSJA IME

Ju nuk e njihni Marën, vogëlushen malësore,  
që ngjitet në skenë e del para fshatarëve,  
që kur flet të duket sikur të merr për dore  
e të çon tutje pyjeve, lëndinave e arave...

Ju nuk e njihni Marën, vogëlushen syshkruar,  
që kur prezanton shokët e shoqet në shfaqje  
dhe këndon me zërin si burim i kulluar,  
nga emocioni, një lulëkuqe i çel në faqe...

Ju nuk e njihni Marën, ëndrrën s'ia dini  
vogëlushes që këndon pas tufës me dele,  
po pas vitesh në skenën e Operas do ta shihni  
me këngën e dashur: «Lindi dielli ndër zabele...»

## NË PRITJE

Hëna, si drapër, rri pezull mbi kreshta,  
sikur bar do të korrë lëndinave malore.  
Këtë çast vjen nga arat një vajzë me gërsheta,  
një vajzë syzezë, plot ëndrra rinore. . .

Vjen ajo tani dhe me vete sjell  
duhamën e plisave, ku djersën ka derdhur,  
duhamën e lirishteve larë me vesë  
dhe në buzë një trëndafil malli të çelur. . .

Qershia lehtë prej flladit do shushurijë,  
mbi flokë e supe do na hedhë lule.  
Do më ngjajë mikja, ashtu e bardhë, e mirë,  
sikur për tek unë shoqet e kanë nisur nuse. . .



## SHOFERJA

Ti mund të rrije me një tufë dhi  
e bareshë të bëheshe në fshat,  
do t'u gëzoheshe kecave të rinj  
që, si ketra, hidhen shpat më shpat.

Do të dilje në tabelë të nderit  
si bareshë e dalluar e kooperativës,  
do të shtrëngonte prapë dorën Enveri  
e do të thoshte: I lumtë Raze Sylës!

Po ti i le dhitë dhe shtegun e malit  
që t'i përshëndetësh me tingujt e borisë;  
shkallmove kanun, zakon e thashetheme  
dhe u bëre shoferja e parë e malësisë.

Kjo nuk ishte e lehtë, motër Raze,  
ti shumë bukur e the në Kongres:  
Sikur ky diell mos të lindte mbi këto male  
një vajzë e mjerë do të kisha mbetë...

## RRUGËVE TË KËTIJ KANTIERI. . .

Rrugëve të këtij kantieri të largët malor  
ecin njerëz me nga një mendim të bukur në kokë;  
s'ankohen nga balta, s'pyesin për shirat,  
që mbi xhupat e mushamatë rrahin si me shkop. . .

Lënë shtretërit e vrapojnë në turn të tretë,  
në ballë vënë llampën e minatorit;  
damarët e shkëmbit çajnë me pistoletë  
dhe me mineral paprâ mbushin vagonat.

Rrugëve të këtij kantieri të ri malor  
ecin njerëz me nga një mendim të bukur në kokë;  
ecin njerëz me shpirtin e pastër punëtor,  
tek mendimi i Partisë mbështetur fort.

## Ë N D E R R I M

Nesër, kur këtu do të vijnë, fëmijët tanë  
me dallgët që përplasen në brigje do të çuditen  
e do të mburren që këtë digë e ngritën baballarët  
që u përleshën me ujërat, me shkëmbinj të dhe ngricën...

Ndoshta atëherë do të jetë prill a maj  
dhe zogjtë mbi drurë do t'i këndojnë blerimit të stinës;  
pak njerëz do të ketë,  
mbi liqen një varkë  
djemtë e vajzat e turnit do të përcjellë pas punës...

Nesër, kur këtu do të vijnë fëmijët tanë,  
varka prej letre do të hedhin në liqen brigjeve, —  
padyshim, prindërve do përpiqen t'u ngjajnë,  
të etur dhe ata për hapësira e shtegtime...



## MONTATORJA ERMALI

*Vajzës që ra për dritën.*

Një ditë papritur i le këto brigje të kaltër,  
(dy lotë tinëz rrodhën prej syve të zes. . .)  
që ne të kujtojmë bardhësinë e zemrës sate  
sa herë në dhomë dritën kemi për të ndezë.

O, ti na le plot kujtime të dashura,  
qyteza jonë për shumë kohë s'do të të harrojë;  
me mall emrin do ta pëshpërisin valëzat,  
si djalosh i drojtur që s'pati guxim të të dashurojë.

Do t'i ruaj gjurmët e vogla rëra e shkrifur e lumit,  
do ta ruaj zërin melodioz era e luginave të malit;  
në apel për ty do të përgjigjen shokët e shoqet e turnit,  
vajzës që do të lindë në kantier do t'i vëmë emrin tënd,  
Ermali. . .

## K O M A N, 1974

Një varkë sjell përmes liqenit punëtorët e turnit  
me nga një rrudhë lodhjeje në ballë,  
me nga një rrezatim drite në sy,  
me nga një gëzim të madh njerëzor  
në zemrën e bardhë,  
se më të mëdhenj për një ditë janë bërë...

Në muzgun e vonuar,  
një shqiponjë rreh flatrat mbi kala...

## DUKE PRITUR VAJZËN

Vala poshtë rridhte e diç belbëzonte me gurët,  
zogjtë në lajthishte melodi të ëmbëla thurnin...

Lëmshi i zjarrtë i diellit në perëndim rrokullisej  
duke marrë pas vetes minutat e fundit të ditës.

Buzë lumit malor, pranë llokoçitjes së valëve,  
minatori Zef skiconte në rërë profilin e së dashurës...

...Vrapin për një çast ndali vala e habitur  
dhe turma e zogjve erdhi që përtej lajthishtes.

Dielli përmbi mal kokën e kishte ngulur...  
O, ç'pritje e denjë për saldatoren e bukur!



## E PUTHI KËNGA BJESHKËN...

E puthi kënga bjeshkën  
e fryu një fllad i ëmbël përzier me  
njomështinë e gjetheve,  
përzier me duhamën e luleve  
e me gurgullimën e gurrave...

Atëherë më ranë në prehrin e këngës  
blegërimat e bardha të grigjave,  
që u zdorgjën\* rudinave të Bokës  
duke ngrënë majën e barit...

E barinjte e thirrën këngën me fyej,  
e bareshat e thirrën këngën me këngë,  
e zogjtë e thirrën këngën me cicërimë.

E puthi kënga bjeshkën  
dhe u bë krejt e saj...

---

\* zbritën, u varën.

## ALMIRËS

*Vajzës sime*

Vajzë e vogël, o Mira, Mira  
që nuk mund të kalosh dot pragun e derës,  
që nuk di se ka jashtë hapësira,  
që nuk di se ka pas derës njerëz! . . .

Do të rritesh e do të bëhesh e madhe, vogëlushe,  
do të jesh vajza më e mirë e fshatit,  
në stallë do mjelësh lopët larushe,  
ugare do çelësh e dyer diturie, bijë e babit. . .

Ty tani të gjithë të thërresin vogëlushja Mirë  
dhe dorën ta japin te pragu i derës;  
ti nesër si zog do të fluturosh ndër hapësira  
dhe do të njohësh sa të mirë e të dashur janë njerëzit.

## MËNGJESËT TANË

Mëngjeset tanë lindin të bardhë,  
të bardha ditët tona  
vijjnë.

Ne me shekuj i kemi pritur  
këta mëngjese.  
Dhe në foletë e hutave  
i kemi rritur  
me shekuj...



## KUJTIMET BARITORE

Kujtimet flenë në kraharorin tim,  
brenda zemrës sime  
me mallin e një grigje.

Kujtimet flenë në kraharorin tim,  
kujtime të hershme  
për shoqen time bareshë.

Çdo pranverë kujtimet baritore blerojnë tek unë  
si rutinë erëmirë bjeshke...

## BARIU ISA

Bariu Isa ka një grigjë delesh  
të bardha, të bardha,  
që i kullot imshtash e zabelesh,  
që u jep ujë gurave të kristalta.

Dhe e rrethojnë bardhokat bariun Isa  
(si te derë e stanit fëmijët),  
Dhe blegërojnë ato për bariun Isa  
për një çast nëse u ikën...

I grish me fyell delet në mrrizë,  
i grish me fyell të bardhat në kullota.  
Krenohet kooperativa me bariun Isa:  
«Bariun tonë s'e ka jo, bota!»

\*

\*   \*

Ç'kishe ashtu në sy,  
ç'dritë të rrezëllonte bebëzat e qeshura?  
Ne bashkë ecnim të dy  
nën qershitë e çelura, ndanë vreshtave.

Pranvera kishte ardhur,  
mjaltin e dashurisë zbraste ndër zemra.  
Qershitë na shkundnin petale të bardha,  
zogjtë me këngë mbushnin hapësirat e gjera...

Në shtegun e blertë ne rendnim dorë për dorë,  
në sy na shkëlqente gëzimi rinor.



## DEKORIMI I BRIGADIERES

Ajo asnjë fjalë nuk gjente të fliste atë çast,  
ndërsa në kujtesë blerimi i drithërave rritej,  
rritej profili i saj në sytë e kooperativistëve...

Pastaj drejt parcelave shikimin ëndërrues hodhi,  
të merrte dekoratën u nis e emocionuar;  
me të zgjateshin duart plot kallo të shokëve e shoqeve.  
Grunorja drejt saj zgjaste kallinj të e pjekur, të  
rënduar...

## KUR SHKOJ NDËR ARA...

Kur shkoj ndër ara më lindin mendime shumë,  
mendimet e mia i ngjajnë grurit e misrit të bardhë.  
Te njerëzit dhe toka frymëzimin e gjejmë,  
te çdo vështrim i çiltër, te çdo brazdë...

Unë vetë bashkë me bujqit tokën kam punuar,  
farën kam mbjellur në pranverë e në vjeshtë.  
Dhe zemra, si bujkut, fort më është gazmuar,  
kur pranë malit të drithërave jamë ndodhur  
në lëmënjtë.

Ndaj, sa herë kur ulem mbi bllok e shkruaj  
dua që vargjet të gjithëve t'u shijojnë si buka,  
t'i këndojë fshatarja ime syshkruar,  
kur duaj lidh, muzgjeve, ndër fusha..

## KËTË MËNGJES. . .

Këtë mëngjes tetori në hapësirën e pamatë të fushës  
era e tokës së sapolëruar më hyri në shpirt.  
Brazdat e fundit që hapnin traktorët  
gufimin e shpejtë të farërave prisnin...

Vajzat kooperativiste, tek uleshin nga kodrat,  
mëngjesin përkëdhelnin me sytë e gëzimit  
dhe ëndërronin stinën e begatë të të korrave...



## PASQYRA E LËNDËS

Merrini këto vargje .....	3
Biri i rapsodit .....	4
Në shtëpinë muze të poetit.....	5
Në kullën time të lashtë, të vjetër .....	6
Hapsani .....	7
Rapsodi .....	9
Motivet e mia .....	11
Mbrëmje bjeshkëtare .....	12
Çast mbrëmjeje .....	13
Kooperativistet e fshatit tim .....	14
Mes grunjave të reja .....	15
Në kopshtet me mollë ka ardhur vjeshta .....	16
Kujtimi i nënës .....	17
Po ta shoh sot ballin .....	18
Unë dhe sharrëxhinjtë .....	19
Në muzgun e qytetit verior .....	20
Ra sharrëxhiu .....	21
Balada e gjyshit druvar .....	22
Jam i emocionuar .....	23
Aty ku lindi kantieri i ri.....	24
Bunari i Grishit .....	25
Saldatorja Rita ka dy fëmijë .....	26
Fëmijët e hidrocentralit .....	27
Motiv nga Kurbneshi .....	28
Për grigjat .....	29
U fejua motra .....	30
Kur pikojnë strehët pranverave .....	31

Gjyshja ime dhe këngët .....	32
«Ti je prapë mes nesh, o trim i ri» .....	33
Mara, nxënësja ime .....	34
Në pritje .....	35
Shoferja .....	36
Rrugëve të këtij kantieri .....	37
Ëndërrim .....	38
Montatorja Ermali .....	39
Koman, 1974 .....	40
Duke pritur vajzën .....	41
E uthi kënga bjeshkën .....	42
Almirës .....	43
Mëngjeset tanë .....	44
Kujtimet baritore .....	45
Bariu Isa .....	46
Dekorimi i brigadieres .....	48
Kur shkoj ndër ara .....	49
Këtë mëngjes .....	50